



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: “Mbi miratimin e tarifave për humbjen e kartës së abonimit dhe humbjen e biletës së parkimit, në parkimet publike : “parkimi goricë ” dhe “parkimi lindor i goricës”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi në zbatim të nenit 8, pika 2 e nenit 9, pika 1/1, shkronja b, nenit 9 pika 1/3, shkronja b, nenit 35, pika 5, shkronja a, nenit 54, shkronja f, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore “ i ndryshuar, nenit 7, pika 1, shkronja e dhe f, pika 8, 10 e 11 të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit nr. 797, datë 20.12.2023 “Për miratimin e Strukturës, Organigramës së Administratës së Bashkisë dhe të Njësive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat” për vitin 2024”, VKB nr. 87, datë 18.12.2021 “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Berat dhe Njësive Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Bashkia Berat ka në pronësi dy ambiente publike pranë Urës së Goricës, “Parkimi Goricë” i cili është ndërtuar në kuadër të projektit “Rehabilitimi i siluetës urbane në lagjen Goricë” me 63 vende

parkimi, gjithashtu është duke krijuar edhe Parkimin publik në pjesën lindore të Goricës (pranë restorant “Dhelpra”) me 32 vende parkimi.

Në kto parkime përdoruesit pajisen me:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Kartë abonimi (për përdoruesit abonentë);
- Biletë parkimi (për përdoruesit rastësorë).

Në rastet e humbjes së kartës së abonimit ose biletës së parkimit, aktualisht nuk ka tarifa të përcaktuara . Kjo mungesë krijon vështirësi administrative dhe mundësi abuzimi nga përdoruesit, duke sjellë humbje të të ardhurave,

Situata financiare : Për të mbuluar kostot e administrimit, të riprodhimit të kartës/biletës dhe për të disiplinuar përdoruesit, propozohet vendosja e këtyre tarifave:

1. Tarifa për humbjen e kartës së abonimit: 1,000 (një mijë) lekë;
2. Tarifa për humbjen e biletës së parkimit: 2,000 (dy mijë) lekë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave dhe Agjencia e Shërbimeve Publike.

Impakti social / grupet që preken:

Tarifat janë të natyrës rregullatore dhe do të mundësojë rregullimin e situatës aktuale dhe zbatimin e një procedure të qartë, duke mbrojtur interesat financiare të Bashkisë.

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**” , i mbledhur në datën 12/09/2025, shqyrtoi projekt vendimin “Mbi miratimin e tarifave për humbjen e kartës së abonimit dhe humbjen e biletës se parkimit , në parkimet publike : “parkimi goricë ” dhe “parkimi lindor i goricës”

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI

1. Të miratojë tarifën për humbjen e kartës së abonimit dhe tarifën për humbjen e biletës së parkimit për dy parkimet ‘‘Parkimi Goricë’’ dhe Parkimi në pjesën lindore të Goricës’’ si vijon:

- Tarifa për humbjen e kartës së abonimit: 1,000 (një mijë) lekë;
- Tarifa për humbjen e biletës së parkimit: 2,000 (dy mijë) lekë.

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit

Anisa Veliu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar

Datë 12 /09/2025